



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.99/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Biznesi Individual “B...”, me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokatja D.S.G. nga Prishtina, kundër të paditurës “B... (...)”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim A.R., për shkak të nulimit të dispozitave të nenit 8.2 të kontratave për kredi me nr...., dhe nr...., lidhur me kamatën ndëshkuese, pasurim i pa bazë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.514/17 e datës 05/02/2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **13/03/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës “B... (...)”, me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.514/17 e datës 05/02/2018, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë **NDRYSHOHET** dhe vendoset ashtu që: **DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padis me 25/07/2016 e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar IV.EK.C.nr.514/17 e datës 05/02/2018, në piken I të dispozitivit ka vendosur që të miraton si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses “B...”, me seli në Pejë, e paraqitur kundër të paditurës “B... (...)”, me seli në Prishtinë, ashtu që ka vërtetuar se dispozita e nenit 8.2, e kontratave mbi Kredinë me nr...., dhe nr...., të lidhur në mes paditëses dhe të paditurës, me të cilën është kontraktuar kamata ndëshkuese, është NUL, dhe nuk prodhon

efekte juridike ndërmjet palëve kontraktuese, mandej në piken II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që të detyron të paditurën “B... (...)”, me seli në Prishtinë, që paditëses Biznesi Individual “B...”, me seli në Pejë, që t’ia kompensoj borxhin në shumën e mjeteve financiare prej 50,819.00 euro, të inkasuar në emër të kamatës ndëshkuese të kredive me nr.... dhe ..., me kamatë ligjore prej 3.5% në vit nga dita e parashtrimit të padisë gjerë në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe në piken III të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që të detyron të paditurën, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 1,546.70 euro, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Paditësja ka dhënë përgjigje në ankesë, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e të paditurës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërteton.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Biznesi Individual “B...”, me seli në Pejë, pran Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 15/07/2016, ka paraqitur padi kundër të paditurës “B... (...)”, me seli në Prishtinë, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësve si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar se dispozitat kontraktuese e nenit 8.2 të Kontratës kreditore bankare me nr.... dhe ..., janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 270 par.3 të LMD-së, sipas të cilës ndëshkimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për

detyrimet në të holla, meqenëse kjo dispozitë është e natyrës imperative, gjykata vlerëson se kamata ndëshkuese si ndëshkim i kontraktuar bie në kundërshtim me normën imperative dhe nuk mund të ketë efekt juridik, andaj të njëjtën komfor nenit 103 të LMD-së e konsideron dispozitë nule, ndërsa me ekspertizë financiare të R.F. është vërtetuar lartësia e kërkesëpadisë, mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në dispozitat e nenit 270 par.3 dhe nenin 103 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452 par.2 dhe nenin 453.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin, mandej në arsyetimin e aktgjykimit të goditur janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike dhe arsye mbi të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë. Parashtrimet në ankese nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike se me neni 8.2 të kontratave kreditore bankare me nr.... dhe ..., palët ndërgjyqëse kanë paraparë penalitetet prej 4 % në muaj e cila rrethanë ishte e pa kontestushme në mes tyre, andaj kjo Gjykatë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë se kamata ndëshkuese e kontraktuar është në kundërshtim me nenin 270 par.3 të LPK-së e cila dispozitë ligjore ka paraparë: *Dënimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla.*

Gjykata e shkalles së parë drejt ka vendosur për lartësinë e kërkesëpadisë duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar R.F., i cili ka ardhur në përfundim se paditësja në emër të kamatës ndëshkuese ka paguar shumë prej 50,818.00 euro e cila ekspertizë është e bazuar në prova që gjenden në shkresat e lëndës. E paditura ...-ja me seli në Prishtinë, gjatë shqyrtimit gjyqësorë me asnjë provë të vetme materiale, nuk e ka kundërshtuar ekspertizën gjyqësore të lartpërmendura, respektivisht nuk ka propozuar nxirjen e ndonjë ekspertize tjetër gjyqësore, që eventualisht do të vërtetonte një gjendje tjetër faktike, nga ajo të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkalles së parë, mbi bazën e provave të administruara. Në këtë situatë juridike ligjvënësi ka paraparë në nenin 319.1 të LPK-së më sa vijon: Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji, gjithashtu ka paraparë: Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se pjesëmarrësit në raportet kontraktuale me vullnetin e tyre i rregullojnë marrëdhëniet e tyre detyrimore, por nuk mund ti rregullojnë ato në kundërshtim me parimet e përcaktuara me dispozitat e detyrimeve respektivisht kjo dispozitë e paraparë kontraktuese është në kundërshtim me nenin 270 par.3 të LMD-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat Gjykata e Apelit, vlerëson se dispozita e nenit neni 8.2 të kontratave kreditore bankare me nr.... dhe ..., është në kundërshtim me normat imperativë dhe nuk prodhon efekt juridik dhe rrjedhimisht e paditura nuk ka mundur të aplikoj, andaj konform nenin 89 të LMD-së, dispozita kontraktuese është nule. Sipas nenit 91 të LMD-së, nuliteti i një dispozite kontraktuese, nuk mund të ketë pasoj edhe në nulitetin e vet kontratës, në qoftëse ajo mund të qëndroj pa dispozitën nule, andaj konform kësaj dispozite kjo gjykatë vlerësoj se kontrata ndërmjet palëve kontraktuese pa këtë dispozitë ka mbetur në fuqi. Me dispozitën e nenit 194 par.1 të LMD-së, ligjvënësi ka paraparë që secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur. Andaj e paditura është e detyruar që të kthej të hollat që i ka marr nga paditësja dhe i mbanë pa bazë ligjore.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së,

meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar. Në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 277 e LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-

Ae.nr.99/18, me datën 13/03/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v